



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

18 tetor 2012, Prizren

REAGIM

Komuna dhe KK-ja e Prizrenit shpërfillin kërkesën e MAPL-së

EC Ma Ndryshe ka siguruar shkresën shpjeguese të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) drejtuar komunave të Kosovës, përmes të cilës sqarohet se kushtëzimi i shërbimeve të komunës ndaj qytetarëve me pagesën e borxheve ndaj Ndërmarrjeve Publike Rajonale e Lokale, nuk kanë bazë ligjore dhe se si të tilla nuk mund të aplikohen.

Më 20 qershor 2012 zv. Kryeministri dhe ministri i MAPL-së, Slobodan Petroviq u ka shkruar kryetarëve të komunave dhe kryesuesve të KK-ve lidhur me kushtëzimin e shërbimeve publike komunale, respektivisht kushtëzimin e regjistrimit të automjeteve me pagesën e faturave të mbeturinave dhe ka konstatuar se kjo është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.

MAPL, ia ka bërë të qartë edhe komunës së Prizrenit, se: "Kufizimi i shërbimeve nga komuna për qytetarët, bizneset dhe operatorët ekonomikë që funksionojnë brenda territorit të saj, me pagesën e faturave të mbeturinave për Ndërmarrjen Publike komunale rajonale, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës".

Në këtë shkresë MAPL ka theksuar se kushtëzimet mund të aplikohen duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 3/2004, që parasheh pagesën e tatimit në pronë me qëllim të pajisjes me dokumente kadastrale, ndërtimore, lejeve të caktuara dhe pronësinë e automjeteve. Në bazë të kësaj MAPL ka kërkuar nga kryetarët dhe kryesuesit që vendimet e tyre t'i nxjerrin në harmoni me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.

Ndonëse sqarimi i MAPL-së është bërë katër muaj më parë, kryetari i komunës së Prizrenit dhe kryesuesi i KK-së, Nijazi Kryeziu nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për anulimin e vendimit të KK-së së Prizrenit për kushtëzimin e dhënies së dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e automjeteve me pagesën e shërbimeve të mbeturinave.

KK-ja e Prizrenit në shkurt të këtij viti me shumicë të thjeshtë votash pat miratuar vendimin në fjalë. Vendimi për kushtëzim është marrë nga KK-ja në bazë të kërkesës së menaxhmentit të njësisë në Prizren të ndërmarrjes publike për menaxhimin e mbeturinave "Ekoregjioni", për shkak të nivelit të ulët të arkëtimit të mjeteve nga bizneset por edhe ekonomitë familjare.

EC Ma Ndryshe përmes këtij reagimi i bën thirrje kryetarit të komunës dhe kryesuesit të KK-së që në afatin sa më të shkurtër kohor të respektojnë shkresën e MAPL-së dhe të ndërmarrin veprimet e duhura në drejtim të anulimit të vendimit jo-ligjor.

EC Ma Ndryshe konsideron se sqarimet e MAPL-së në këtë drejtim janë të qarta dhe se ato duhet të zbatohen pa asnjë vonesë, me qëllim të mos cenimit të drejtave të qytetarëve të komunës së Prizrenit.

Po ashtu EC Ma Ndryshe kërkon nga qytetarët dhe bizneset që t'i paguajnë me rregull faturat e mbeturinave.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012 përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.